

Raport Final në lidhje me vizitën në institucionin e Universitetit të Prishtinës

DEPARTAMENTI I BALLKANISTIKËS

Eksperti: Ass. Prof. Dr. Ljiljan Reinkowsky, Universiteti i Bazelit

Hapi i parë i vlerësimit të programit Bachelor në *Ballkanistikë*

Programi BA në Ballkanistikë:

(1) Të akreditohet me kushtin që të ketë personel me orar të plotë (preferohet të jetë të paktën i nivelit të asistent profesorit) që do të ishte përgjegjës për zhvillimin e mëtejshëm dhe organizimin e programit BA.

(2) Në lidhje me mësimdhënien e gjuhëve tjera ballkanike, përveç asaj shqipe (si boshnjakisht, kroatisht, serbisht, bullgarisht, maqedonisht, greqisht, rumanisht, turqisht) do të ishte me rëndësi që të pranohet personel mësimdhënës i kualifikuar.

(3) Ndeshja në mes titullit të programit (ballkanistikë) dhe përmbajtjes (duke qenë se vihet theks mbi linguistikën dhe filologjinë ballkanike) në një masë shkakton konfuzion, megjithëse nuk është relevante për procesin e akreditimit.

Si rrjedhojë e pikës (1) dhe (2) akreditimi mund të jepet tani vetëm për një periudhë të kufizuar deri në dy vjet.

Prospekti për studimet MA:

Nevoja për të pasur personel permanent që do të kishte përgjegjësi ekskluzive për këtë program studimesh është edhe më e madhe kur kihen parasysh planet e ardhshme për ngritjen e një programi MA në Ballkanistikë. Është për t'u përhëndetur synimi i Fakultetit të Filologjisë që të zhvillojë një drejtim studimesh në nivelin MA në Ballkanistikë, në të cilin do të theksohej më shumë aspekti historik dhe kulturor.

Bazë e këtij raporti është:

1. Raporti i vetë-vlerësimit (RVV) i Fakultetit të Filozofisë, Universiteti i Prishtinës, i titulluar: "Një pasqyrë e përgjithshme e Fakultetit të Filologjisë – për qëllim të aplikimit për akreditim të dy programeve të reja studimore dhe riakreditim të tri programeve studimore në AAK).
2. Dëshmitë personale të marra gjatë vizitës në institucion më 4 qershor, 2011 prej orës 9 deri 16:30.
3. Komentet e dërguara nga Fakulteti i Filologjisë përmes AAK më 22 qershor.

Gjatë takimit të parë me personat përgjegjës për programin studimor të shtunën më 4 qershor, 10-12 paradite, u prezantua programi i parë BA me titull *Ballkanistika*, ai u prezantua nga Dr. Rexhep Ismajli, Profesor i Linguistikës dhe i Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Filozofisë, UP dhe Dr. Bardh Rugova, Kryesues i Departamentit të Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Filozofisë, UP.

Gjatë takimit të dytë me personelin mësimdhënës (po të njëjtën ditë, prej 15-16) morën pjesë profesorët në vijim: Dr. Sedat Kuçi (fatkeqësisht, me material nuk u pranuan CV; sipas “përshkrimit të përgjithshëm” Profesor Kuçi punon në fushën e gjuhëve komparative ballkanike), Dr. Enver Mehmeti, Profesor për literaturën folklorike në Departamentin e Letërsisë Shqiptare dhe Dr. Shkumbin Munishi (fatkeqësisht pre CV nuk është e qartë se çfarë pozite mban)

Programi: “Ballkanistikë” - koncepti dhe titulli

Një diskutim i gjerë në lidhje me BA gjatë takimit me personat përgjegjës, zbuloi faktin se titulli i programi është disi i gjerë në krahasim me përmbajtjen e kurrikulës. Gjatë takimeve u bë evidente që personat e ngarkuar me konceptin, janë të vetëdijshëm për këtë problem. Por, duke u nisur nga rrethanat e tanishme (organizimi i përgjithshëm i universitetit, p.sh. fakulteti, shih fundin e këtij raporti) nuk vërehet mundësia për një koncept më të gjerë, duke përfshirë studimet kulturore dhe sociale në temat që kanë të bëjnë me Ballkanin. Gjatë diskutimeve Ekipi i Ekspertëve (EE) rekomandoi të rikonsiderohej titulli “Ballkanistika” dhe të riemërtohet “Gjuhët Ballkanike” ose “Linguistika Ballkanike”. (Sipas formës së tanishme të programit, pjesa filologjike mbulon rreth 85% të lëndëve obligative, si dhe 66% të të gjithë programit). Në përgjigjen e dërguar më 22 qershor është theksuar se ata mëtojnë të mbajnë titullin e parë të konceptit dhe se ky titull i programit, pra “Ballkanistika” përputhet mirë. Një koncept më i gjerë do të ndryshonte synimet dhe qëllimet e programit të parapara në kornizën e njësisë akademike të Fakultetit të Filologjisë, që në rend të parë është i përqëndruar në qasjen filologjike. Në përgjigje, poashtu është argumentuar se programi i ri nuk duhet të konsiderohet si një filologjik i pastër. Është planifikuar që programi të zgjerohet në një program Master dhe në këtë nivel të studimeve theksi të kalojë në kulturë, histori dhe gjeografi.

Kurrikula:

Pjesa kryesore e kurrikulës Bachelor (8 semestre) përqëndrohet në dy gjuhë, që janë (1) shqip dhe (2) një gjuhë shtesë nga gjuhët ballkanase në vijim: boshnjakisht, kroatisht, serbisht, bullgarisht, maqedonisht, greqisht, rumanisht, ose turqisht. Përveç lëndëve në lidhje me gjuhët, një pjesë e dytë substanciale e kurrikulës përbëhet nga literatura ballkanase dhe ajo shqiptare.

Historiku i këtyre dy shtyllave (gjuha dhe letërsia) në programin e BA do të përbëhet nga lëndët në historinë e Ballkanit, historinë e artit në Ballkan, mediat, religjioni dhe gjeografia politike e Ballkanit. Programi do të plotësohet nga ligjëratat në linguistikën e arealit dhe atë të linguistikës së kontaktit, të literaturës komparative, latinishtes dhe greqishtes së vjetër. Kurrikula poashtu merr parasysh metodologjinë shkencore.

Në lidhje me politikën e përgjithshme dhe me gjendjen shoqërore në Kosovë dhe strukturën e vet nacionale si dhe fakin që gjuhët (boshnjake, serbe dhe kroate) janë ofruar për mëse 20 vjet në UP, kjo duhet të konsiderohet si një përpjekje e çmuar që të tejkalohet boshllëku në mësimdhënie dhe në punë kërkimore në gjuhët sllave. Mundësia e studimit të bullgarishtes dhe maqedonishtes sigurisht se do të kontribuojë në këto përpjekje. Një mundësi shtesë për studimin e greqishtes, rumanishtes dhe turqishtes (për fillestarë) do të japë një mundësi për zgjerimin e shtrirjes dhe në të njëjtën kohë t'iu mundësojë studimin e karakteristikave të përbashkëta të këtyre gjuhëve ("Balkansprachbund").

Në përgjithësi ky koncept kurrikular përputhet me standaret evropiane dhe me praktikën e zakonshme në Evropë: gjuhët, linguistika, sfondi historik dhe mjedisi kulturor.

Mësimdhënia

Gjatë takimit të EE me përfaqësuesit e programit u kuptua se shumica e lëndëve do të ofrohen nga mësimdhënës që tashmë punojnë në Departamentin e Gjuhës shqipe dhe në atë të letërsisë shqipe. Detyra e mësimdhënies së gjuhëve përkatëse do të merret përsipër nga pjesëtarët e personelit akademik në Fakultetin Filologjik. Sfondi historik dhe ai kulturor do të jepet nga personeli akademik nga Fakulteti Filozofik. Sipas të dhënave të marra nga zëdhënësi i ngarkuar me program, pjesa më problematike mbetet të jetë çështja se cilët mësimdhënës akademikë do të mbulojnë temat në lidhje me gjuhët e sllavëve jugorë (boshnjakisht, serbisht, kroatisht (BSK), bullgarisht dhe maqedonisht) dhe literaturat respektive në këto gjuhë. (u theksua fakti se një ish kolege nga Sarajeva tashmë ka shprehur interesimin e saj për të ardhur në Prishtinë dhe të japë mësim në fushën e gjuhëve BSK).

Personeli që jep lëndët e bullgarishtes, maqedonishtes, greqishtes së re, rumanishtes dhe gjuhëve romane duhet të gjendet dhe të angazhohet deri në vitin akademik 2012/13 kur do të ofrohen këto gjuhë (sipas kornizës ekzistuese të kurrikulës).

Një analizë e kurrikulës tregonte se lëndët zgjedhore ofrohen në mes semestrit të 3-të deri te i 8-ti. Fatkeqësisht, gjatë semestrit III, IV, V dhe VI, ofrohen vetëm tri lëndë zgjedhore në vend të 4 (në këtë mënyrë mungojnë 4 lëndë). Në Komentet e dërguara më 22 qershor, u theksua fakti se Fakulteti i Filologjisë do të ofrojë këto lëndë (në mënyrë që të mbushë boshllëkun):

Për semestrin e tretë: Etnologjinë e Ballkanit,

Për semestrin e katërt: Arkitekturën e Ballkanit,

Për semestrin e pestë: Mitologjinë e Ballkanit,

Për semestrin e gjashtë: Historinë politike moderne

Këto lëndë shtesë janë të përpiluara mirë dhe do të plotësojnë dhe zgjerojnë gjithë programin.

Gjatë takimit me EE më 4 qershor, u bë e qartë se personi/personat përgjegjës për programin nuk janë përzgjedhur ende. Veç kësaj, sipas informatave të marra gjatë takimit, nuk është e qartë nëse do të pranohet mësimdhënësi akademik në nivelin e profesorit, jo vetëm të veprojë si person

përgjegjës në programin A, por poashtu të përfaqësojë disiplinën e Ballkanistikës në Universitetin e Prishtinës. Sidoqoftë, është shumë me rëndësi që ekziston bërthama e personelit që do të garantojë suksesin e programi Bachelor që nga fillimi. Në komentin e dërguar më 22 qershor, EE ishte informuar se personi i ngarkuar, i cili do të koordinojë, zhvillojë dhe kontrollojë programin do të jetë Prof. Dr. Rexhep Ismajli. Prof. Ismajli është një shkencëtar i mirënjohur, me shumë përvojë dhe i vlerësuar, por si rrjedhojë e moshës së tij (64) dhe rregullave të pensionimit në Universitetin e Prishtinës, nuk mund të shihet një perspektivë afatgjate për një ngritje të programit në mënyrë stabile, si dhe të trupës studentore relevante. Në mënyrë që ky program BA të shndërrohej në një sukses, ai do të duhej të organizohej në një bazë afatgjatë, p.sh. ose do të duhej që kontrata e punës e Prof. Ismajlit të vazhdohet për një shtrirje kohore të caktuar, ose do të duhej zgjedhur një person më të ri dhe Prof. Ismajli të jetë këshilltar i çmuar i tij.

Përveç këtyre vërejtjeve teknike, por relevante, EE beson te cilësia e mësimdhënies së stafit, duke qenë se shumica e personave kanë dhënë mësim në fushën e gjuhëve dhe letërsisë në UP.

Puna kërkimore

Bazuar në përvojën e tyre të gjerë, shumica e mësimdhënësve në temat që kanë të bëjnë me Ballkanin kanë krijuar kontakte të mira profesionale dhe kanë qenë aktiv sa i përket ndërkombëtarizimit. Kjo dëshmohet nga konferencat ndërkombëtare të rregullta në fushë. Sipas informatave të dhëna gjatë “takimit me personat përgjegjës”, ekzistojnë kontakte relevante me universitetet në Kalabri, Çikago, Ohajo, Lublanë, Zagreb, Mynih, Shkup, Tiranë dhe veçanërisht me Selanikun.

Gjatë vizitës në institucion, ishte theksuar se Fakulteti i Filologjisë ofron programe me vetëm një disiplinë, një mënyrë kjo e specializimit të hershëm që shpjen në një program të ngushtë dhe të njëanshëm. Në staza të gjata, Fakulteti i Filologjisë do të duhej të shqyrtonte mundësinë që të ofronte programe që do t’iu mundësonin studentëve të tij që të studiojnë në dy disiplina paralelisht në vend të vetëm një. Në këtë mënyrë studentët do të mund që të përfitojnë një edukim më të gjerë (tematikisht dhe metodologjikisht) dhe në të njëjtën kohë ata do të ishin më garues në tregun e punës. Fakulteti i Filologjisë, poashtu do të afrohej më afër (duke mos marrë parasysh shumë veçanti të programeve studimore BA në gjithë Evropën) me standardet e përgjithshme evropiane, që kërkojnë një qasje më të gjerë. Si rrjedhojë e këtij kompatibiliteti, në këtë rast studentët do të mund t’i vazhdonin studimet e tyre jashtë vendit pa asnjë problem.

DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE LETËRSISË GJERMANE

Eksperti: Univ. Prof. Peter Ernst, Universiteti i Vjenës

Nëndekani shpjegon pengesat kryesore: thënë në përgjithësi, fakulteti nuk ka para. Suksesi i programeve të shkëmbimit akademik, siç janë ERASMUS ose BASILEUS varen shumë nga vullneti i shteteve partnere. I fundit, por jo më pak i rëndësishëm është edhe fakti se tani për tani mosha e pensionimit është 65, gjë që shkakton mungesa të mëdha të personelit akademik.

Diskutimet me personelin kanë treguar se shumica e gjërave që duheshin bërë si rrjedhojë e vizitës së vitit 2010, tashmë ishin zbatuar. Kështu, është përpiluar kurrikula, u siguroa prezenca në internet (faqe interneti) me përmbajtjen e vet, si dhe me përdorimin e kompjuterëve në bibliotekë, poashtu janë planifikuar e organizuar edhe kontakte ndërkombëtare (p.sh. me Universitetin e Vjenës). Disa nga çështjet nuk janë trajtuar, pasi që ishin jashtë domenit të departamentit, p.sh. kompetenca buxhetore ose anulimi i lëndës “Gjuha dhe Letërsia Shqipe”.

Kurrikula:

Tani për tani në dispozicion të studentëve është një program BA trevjeçar, i cili u mundëson atyre që të punojnë si mësimdhënës. Personeli pajtohet se një vit shtesë i MA do të ishte i nevojshëm për të ofruar studimet të thelluara. Më tej, programi katërvjeçar (kurrikula) (tri vjet BA plus një vit MA) do të duhej ndarë në degë për mësues dhe një degë tjetër për përkthyes.

Kurrikula e tanishme është shumë ambicioze, ajo përmban temat kryesore nga gjuha dhe letërsia gjermane, në formë të lëndëve të ndryshme në letërsi, lëndë në aftësitë gjuhësore, literaturë (edhe me fillimin e literaturës mesjetare gjermane) si dhe shkathtësitë moderne siç janë pragmatika dhe semantika. Një ngarkesë e madhe është në leksikografi. Është për t’u habitur fakti se vihet theks në variacionet gjuhësore lokale (gjermanishtja zvicerane, gjermanishtja austriake), të njohura me shkurtesën DACHL, që paraqet një problem të madh në mësimdhënien e gjermanishtes si gjuhë e huaj. Lëndë të veçanta trajtojnë interesime të veçanta siç janë filmat gjermanë, ekonomia gjermane, etj. Kësisoj kurrikula është e një standardi të lartë dhe e azhornuar.

Mësimdhënia:

Personeli mësimor është mjaft i kualifikuar dhe i motivuar. Kolegët që pata nderin t’i takoja ishin njohës të mirë të gjermanishtes, pa ndonjë akcent në të folur ose mungesa në gramatikë dhe pragmatizëm. CV-të dëshmojnë për faktin se i gjithë personeli mund të ofrojë një kurrikulë të guximshme nga aspekti akademik pa asnjë problem. Mosha mesatare e personelit është relativisht e ulët. Në një anë kjo paraqet një avantazh të madh, pasi që mësimdhënësit janë të etur të punojnë dhe të ngriten në karrierë akademike. Në anën tjetër kjo rezulton në faktin se vetëm disa profesorë (dy tani për tani) që është larg nga ajo se çfarë kërkohet për mbulimin e nevojave për tutorim personal të studentëve. Kështu që, synimet për të ardhmen e afërt do të duhej të ishin në promovimin e disa pjesëtarëve të personelit në nivelin PhD (që siç më është thënë është në proces e sipër) dhe të mbushet ky boshllëk sa i përket mungesës së profesorëve. Por, nuk ka dyshim se

departamenti është në rrugë të mbarë të zgjidhë këto probleme. Është për lëvdatë bashkëpunimi me Bibliotekën Austriake dhe me mësimdhënësit e „Österreichisches Sprachdiplom“.

Personeli mësimor nuk do të donte t'i largonte provimet në fillim të studimeve. Tani për tani, ka pesë provime për semestër, gjë që është shumë. Ky numër do të duhej zvogëluar. Janë shumë të nevojshme disa pajisje më teknike si kompjuterë, projektorë, etj.

Puna kërkimore:

Nuk ka nevojë të theksohet se ka probleme. Problemi kryesor sigurisht se paraqesin mjetet financiare, gjë që nënkupton se buxheti i departamentit duhet të sigurohet dhe departamenti vetë do të duhej të vendoste në lidhje me përdorimin e tij.

Një problem tjetër është edhe nevoja për më shumë mësimdhënës dhe reduktimi i provimeve gjatë semestreve. Tani për tani, personeli mësimor mund t'ia lejojë vetes vetëm pak kohë për hulumtime shkencore, kjo si rrjedhojë e këtyre arsyeve. Sidoqoftë, ata publikojnë rreth 2 ose 3 punime në revista ndërkombëtare, që paraqet një numër të madh në këto rrethana. Këto shifra të publikimeve mund të rriten lehtësisht sapo të zgjidhen problemet në lidhje me kohën.

Vërejtje të përgjithshme

Departamenti i gjuhës dhe letërsisë gjermane në UP duket se është në gjendje shumë të mirë. Personeli është i ri në moshë, i kualifikuar mirë dhe i etur për të krijuar një kurrikulë ambicioze. Rekomandimi i EE është se duhet të ketë një program katërvjeçar MA me dy degë (një për mësimdhënës dhe tjetra për përkthyes) pa ndonjë kufizim në akreditim dhe për të mbështetur personelin që do të promovohen, duke iu dhënë statusin e profesorit dhe duke mbushur boshllëkun me personel të ri. Numri prej pesë testesh për semestër duhet zvogëluar.

DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT/MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Eksperti: O. Univ. Prof. Dr. Thomas A. Bauer, Universiteti i Vjenës

Për Departamentin e Gazetarisë, kjo vizitë në institucion ka qenë si rrjedhojë e vizitës së parë vlerësuese. Rekomandimet e vizitës së vitit të shkuar ishin:

- Ofrimi i një akreditimi njëvjeçar për programin në gazetari dhe në marrëdhënie me publikun, në mënyrë që t'iu jepet shans dhe sfidë për të zhvilluar strukturën e kurrikulës dhe të resurseve mësimdhënëse.
- Përmirësimi i rrjetit ndërkombëtar në punë kërkimore, në mësimdhënie dhe shkëmbimi i mësimdhënësve dhe personelit.
- Krijimi i një programi institucional për punë kërkimore në media dhe komunikim, në mënyrë që t'i shërbejë nevojave të dijes dhe fitimit të saj në lidhje me mediat, shoqërinë dhe zhvillimin politik, kjo në kontekst lokal.

Në këtë vit si pjesëmarrës në takim nga ana e UP ishin nën Dekani Pr. Rugova, Udhëheqësi i Departamentit Prof. Krasniqi dhe Ass. Prof. Linditë NN, dhe Remzije Shahini – Hoxhaj, në takimin tjetër ishte personeli: Lulzim Pllana, Albun Zeneli dhe Bajram Kosumi. Ky takim i vitit 2011 dhe raportet në përgatitje të tij, kishin për qëllim të vlerësonin përparimin dhe progresin që është bërë që nga vizita e parë gjatë vitit të shkuar.

Në përgjithësi, sa i përket raporteve të shkruara dhe reagimit ndaj raporteve personale gjatë takimit, të dhëna nga fakulteti dhe menaxhmenti i departamentit, nga personeli mësimdhënës dhe studentët, përshtypja e EE thjeshtë ishte se:

Është bërë progres i ndjeshëm nga departamenti në lidhje me përmirësimin e të gjithë faktorëve relevantë të cilësisë dhe në përmbushjen e standardeve të larta në punë kërkimore, mësimdhënie, ndërkombëtarizim dhe menaxhim programi. Përveç efekteve anësore që u vërejtën, poshtu të rëndësishme ishin edhe:

EE fitoi përshtypjen se ka një përfshirje të shkallës së lartë dhe identikim, të një shkalle të lartë të krenarisë institucionale duke thënë se zhvillimi duhet të jetë në interes të departamentit dhe jo vetëm si një favor që i bëhet AAK, si dhe ishte përshtypja që një përparim i bashkëpunimit në interes të dukshmërisë së cilësisë së studimeve, përbrenda departamentit. Ishte për t'u çmuar balansi i mesazheve në mes deklaratave të menaxhmentit të departamentit, personelit të departamentit dhe studentëve.

Kurrikula:

Raportet dhe prezantimi i bërë gjatë takimit arritën të bindin se janë bërë përpjekje të rëndësishme në lidhje me pasurimin e kurrikulës, duke e orientuar atë në programe kurrikulare në Universitetin e Lublanës dhe Universitetin Evropian të Tiranës. Me të dyja universitetet, duke përcjellë këtë interesim dhe synim, është arritur një memorandum mirëkuptimi në mënyrë që të përmirësojë bashkëpunimin si dhe standardin evropian të kurrikulës.

Mësimdhënia:

Mësimdhënia u përmirësua duke qenë se është orientuar nga puna kërkimore siç janë puna kërkimore në mediat e shtypura, metodat kërkimore, gjuha dhe ideologjia, komunikimi politik, dizajni dhe gjuha shqipe, të gjitha këto me synim të plotësimit të kurrikulës (sidomos në programin master). Siç u tha edhe nga Prof. Krasniqi, programi Master do të zbatohet në tetor 2011, 20 studentë tashmë janë regjistruar si pjesëmarrës.

Programi BA:

Gjatë diskutimeve në lidhje me ndërkombëtarizimin dhe orientimin ndaj tregut lokal të mediave, u raportua që kurrikula është përshtatur që të jetë më afër me kërkesat e tregut në rajon. Sipas raporteve, 60% e të diplomuarve integrohen në vende të punës në tregun e punës rajonal. Ky është edhe synimi i programit BA. Kjo është arsyeja pse janë kyçur mësimdhënësit nga mjedisi profesional. Brenda këtij programi të studimeve të gjëra në lidhje me komunikimin, studentët do të duhej të bëheshin më të aftë që të bëjnë punë cilësore në marrëdhëniet me publikun dhe në mjedisin medial.

Programi MA:

Programi MA në Gazetari dhe në Marrëdhënie me Publikun, që është i bazuar gjerësisht në programin kurrikular, i cili është bërë në Universitetin e Lublanës, si dhe përmes mbështetjes në personel që vijnë nga Lublana dhe Tirana, ka si përmbajtje dimensione më shkencore të metodologjisë, teorisë dhe analizës shkencore. Programi MA, siç është cekur tashmë, është i gatshëm të fillojë në tetor 2011.

Ka plane që të ngritet një program në Leximin Mediatik, i cili poashtu do të duhej të ishte i ndërlidhur me disiplinat tjera siç janë Edukimi dhe Shkencat Kulturore. Studentët theksuan se janë të përkushtuar ndaj programit të ri master, që është i përfshirë në zhvillim dhe punë kërkimore.

Programi i Doktoratës:

Ka plane të krijohet një program për studime të doktoratës. Ky proces veç sa ka marrë statusin e finalizimit, duke qenë se koncepti do të shkojë në senat, ku do të miratohet. Programi përfshin 6 semestre. Shpërndarja e lëndëve obligative dhe atyre zgjedhore është tashmë e strukturuar dhe i përmbush strukturën e programit siç bëhet edhe në vende tjera. Mbetet të theksohet se ka propozime që studentët e nivelit PhD të dërgohen jashtë vendit në dy semestret e fundit, në mënyrë që të përmirësojnë profilin e tyre ndërkombëtar. Ende nuk është e qartë se kush do të japë mësim në program dhe do ta mbikqyrë punën kërkimore të (siç është planifikuar tashmë) 3 deri 5 studentëve të doktoratës, kjo pasi që nuk ka personel të mjaftueshëm të kualifikuar, kjo po që se nuk merren nga Tirana ose Lublana ose profesorë tjerë të ftuar nga universitete tjera.

Puna kërkimore:

Instituti i Mediave:

Në këtë fushë specializimi, Departamenti i Gazetarisë ka treguar një sukses të ndjeshëm, pasi që ka ngritur dhe themeluar Institutin e Mediave që do të duhej të fillonte punën më 1 tetor 2011. Struktura e Institutit të Mediave është e përkushtuar ndaj punës kërkimore (analizës së mediave, analizës së diskursit mediatik, hulumtimit të opinionit, komunikimit politik, gazetarisë, marrëdhënieve me publikun, tregut mediatik, ndryshimit mediatik, etj). Përpjekjet e këtij instituti do të duhej t'i shërbenin shoqërisë kosovare në vetë-analizë dhe vetë-reflektim. Instituti i

Mediave është themeluar në nivel universitar dhe do t'i ndajë të hyrat sipas një sistemi të distribuimit prej 60 me 40, 60 përqind e të hyrave i shkojnë UP, 40 përqind Departamentit të Gazetarisë.

Portali i internetit është larg nga të qenit i realizuar. Universiteti i Tiranës, që është me përvojë të madhe në Analizën e Diskursit Mediatik, do të duhej të përfshihej në këtë nismë, kjo edhe si rrjedhojë e ndërlidhje përmes gjuhës dhe kulturës së përbashkët. Mësimdhënësit, ligjëruesit dhe studentët e MA (në të ardhmen PhD) do të duhej të integroheshin në programin e punës të Institutit të Mediave (për t'i përgatitur studentët për punë kërkimore).

Ndërkombëtarizimi:

Janë organizuar konferenca ndërkombëtare në lidhje me Rolin e Mediave në Shoqërinë Kosovare, si dhe në Digjitalizimin e Mediave. Këto konferenca sjellin ekspertë ndërkombëtarë në Prishtinë dhe mësimdhënësve lokalë iu ofrojnë mundësi që të takohen me ta dhe të shkëmbejnë ide dhe njohuri. Janë bërë edhe nisma që të sjellen ligjërues të huaj në formë të kollokuiumeve, ligjëruesve të ftuar (veçanërisht në gazetarinë radiofonike dhe atë pamore), poashtu duke i dërguar mësimdhënësit në universitete të jashtme (p.sh. Merilend). Edhe studentët përmendën efektin pozitiv të ndërkombëtarizimit në vijim në mësimdhënie siç theksuan zhvillimet e përgjithshme brenda departamentit: libra të reja në bibliotekë dhe që është më e lehtë t'iu qasesh, por ata poashtu përmendën problemin që të gjitha librat relevante janë në anglisht. Pra, nuk ka libra në gjuhën shqipe, që i referohen mjedisit mediatik në Kosovë ose në rajon.

Përmbushja e Rekomandimeve të Ekspertëve:

Në përgjithësi ka shumë përmirësime:

Puna kërkimore: Instituti i Mediave


Programi mësimor: ligjërues të rinj, njësi të reja mësimore në teori dhe metodologji, pasurim i përmbajtjes mësimore, i metodave dhe i mësimdhënësve, ngritja e programit të studimeve të doktoraturës, të revistës mediatike

Ndërkombëtarizimi: konferenca (të organizuara dhe të bashkëorganizuara), udhëtimet jashtë vendit, mësimdhënës nga universitetet e tjera (shkëmbimi i personelit), marrëveshja me emituesit publikë, bashkëpunimi me agjencitë mediatike (p.sh. një ligjërues për gazetarinë investigative), duke e bërë departamentin më të fortë në peisazhin mediatik.

Rekomandim:

Akreditim për të gjitha programet (BA, MA) për tri vjet. Programi Doktoratë së pari duhet të përpilohet në mënyrë që të krijohet një pamje e qartë për ambicjet dhe cilësinë e tij.

Në emër të Ekipit të Ekspertëve:



O. Univ. Prof. Dr. Thomas A. Bauer, Departamenti i Komunikimit në Universitetin e Vjenës, 8 qershor 2011

RAPORT I VLERËSIMIT, qershor 2011

Masteri Profesional në Përkthim dhe Interpretim

Fakulteti i Filologjisë
Universiteti i Prishtinës
Prishtinë, Kosovë

Për Agjencinë e Akreditimit të Kosovës (AAK)

Vlerësuesi i jashtëm:
Yves Gambier, Turun Yliopisto/Universiteti Turku, Finlandë

Turku, 10.06.2011

1. Historiku dhe synimet
2. Kontaktet
3. Në lidhje me kurrikulën
4. Rekomandimet
 - a) Para fillimit të studimeve në tetor 2011
 - b) Të zhvillohen gjatë vitit të parë 2011-2012

I HISTORIKU DHE SYNIMET

Vlerësimi i Masterit Profesional në Përkthim dhe Interpretim (MA) është sugjeruar nga AAK. Unë jam ftuar që të marr pjesë si ekspert, më 28 maj 2011.

AAK ka pranuar një kërkesë nga MASHT që të vlerësojë programet studimore në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, duke përfshirë edhe MA në Përkthim dhe Interpretim, që është një program i ri studimesh që do të fillojë në 2011/2012.

Aranzhimet praktike janë bërë në një mënyrë mjaft efikase nga AAK, disa ditë para vizitës në institucion më 7-8 qershor 2011.

Unë pranova para vizitës (më 31 maj) një numër dokumentesh: Kodin e praktikave të mira për vizitë në institucione të AAK (4 faqe), Udhëzimin e AAK për ekspertë (3 faqe), Standardet e AAK (4 faqe), një pasqyrë të përgjithshme të Fakultetit të Filologjisë (173 faqe) dhe tre formularë që duhej plotësuar (në lidhje me konfirmimin, të dhënat bankare dhe konfidencialitetin).

Programi MA në Përkthim dhe Interpretim është përpiluar brenda Projektit Tempus (2007-2011) në bashkëpunim me ITIRI (Institut de traducteurs, d'interprètes et de relations internationales) të Universitetit Marc Bloch të Strasburgut (Francë), me Institutin e Lartë për Përkthyes dhe Interpretues të Scuole Civiche di Milano, si dhe Departamentit të Përkthimit në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Lublanës (Slloveni).

Projekti Tempus kishte tri synime kryesore:

- Të ngrisë një qendër linguistike
- Të ngrisë një MA në përkthim dhe interpretim
- Të ofrojë arsimim të mëtejshëm të përkthyesve dhe interpretuesve që ushtrojnë këto profesione.

Ky raport nuk është vendi ku përmbledhen hapat dhe procedurat e ndërmarra nga MA gjer më tani, si dhe në lidhje me arsyet e ndryshme për të cilat është vonuar ky projekt (2009-2011). Senati i Universitetit tashmë ka miratuar projektin.

Synimet e vizitës sime ishin:

- Të kuptoheshin të mirat dhe dobësitë e programit MA
- Të vlerësohej cilësia e programit, veçanërisht në krahasim me programet evropiane të ngjashme.
- Të vlerësoheshin pjesë të ndryshme të programit, koherenca dhe përmbajtja e tyre.
- Të vlerësohen resurset e ndryshme humane, financiare dhe teknike për programin e ri.
- Të vlerësohet mundësia e ofrimit të programit që të fillojë zbatimin në tetor 2011.

2. KONTAKTET

Personat në vijim ishin kontaktuar /intervistuar gjatë vizitës sime:

- Dr Ferdije Zhushi-Etemi, Presidente e AAK

Për menaxhmentin e Fakultetit:

- O. Gashi, Dekani i Fakultetit të Filologjisë
- Z. Gruda, Koordinator i Zhvillimit Akademik
- L. Rugora, Prodekan për Mësimdhënie
- M. Polisi, Prodekan për Financa
- V. Sadriu, Sekretar

Përfaqësuesit e personelit mësimor:

- Sasana Çapriqi, Departamenti i Anglishtes, ka përpiluar programin MA me partnerë të ndryshëm të involvuar në projektin Tempus
- Lindita Tahiri, Departamenti i Anglishtes dhe Departamenti i Gazetarisë, ishte koordinatorja e Kosovës në programin Tempus (2003-2010)
- Nerimane Kamberi, Departamenti i Frëngjishtes
- Blerta Ismajli, Departamenti i Gjermanishtes

Vizita Mjedisve të Fakultetit (2 dhoma kompjuterësh):
L.Rugora, M. Polisi dhe Lindita Tahiri.

Marrë në përgjithësi, gjatë vizitës sime unë pata mundësinë të prek çështje të ndryshme dhe pata diskutime të dobishme me këta persona. Të gjitha pyetjet e mia morën përgjigje të qarta dhe përmbajtësore. Sigurisht, duke qenë se programi nuk është ende në funksion, ka disa çështje që ende mbesin të hapura, siç janë politika e pranimi të mësimdhënësve, të studentëve, raporti numerik i mësimdhënësve, materiali mësimdhënës, burimet e bibliotekës, studimi jashtë vendit, punësimi i të diplomuarve, etj. Sido që të jetë dhe shkurtimisht më duhet të them programi mund të fillojë në tetor 2011.

Të gjitha komentet dhe rekomandimet e mia si më poshtë, janë të bazuara në dokumentet që kam lexuar dhe në interaksionin gjatë bisedave që kam pasur, ato janë të theksuara me qëllimin që të inkurajojnë zbatimin e programit pa vonesa të tjera.

3. SA I PËRKET KURRIKULËS

Programi MA në Përkthim dhe Interpretim është një program transversal, i zbatuar përmes Departamenteve të gjuhëve të ndryshme dhe nuk paraqet departament në vete. Ai ka për synim ofrimin në dy vjet me 120 kredi ECTS (30 kredi për semestër prej 15 javësh) “të personelit të kualifikuar që të bëjë përkthime dhe interpretime cilësore, si dhe shërbime të tjera që kanë të bëjnë me përkthimin dhe interpretimin në mënyrën më efikase të mundshme, gjithnjë duke respektuar etikën profesionale të përkthyesit ose interpretuesit”. (f. 123, në “Master Profesional në Përkthim dhe Interpretim”, të përfshirë në dokumentin e titulluar *Një pasqyrë e përgjithshme e Fakultetit të Filologjisë*, i datës 29.12.2010).

Në mënyrë që të arrihen këto synime, nga të gjithë partnerët e përfshirë duhet të tejkalohen të ashtu-quajturat dikotomitë në mes profesionit dhe punës kërkimore, punës praktike dhe teorisë, trajnimit dhe edukimit. Një praktikë profesionale pa një bazë solide, shpejt shndërrohet në rutinë

pa shans për zhvillim të mëtejshëm. Një pjesë e punës kërkimore që nuk bazohet në punë praktike nuk mund të shpjegojë asgjë dhe nuk ka vlerë për shoqërinë tonë. Alternativa nuk duhet të jetë në mes të një shkolle profesionale ose universitare dhe një Politekniku. Sot, njohuritë dalin në të shumtën nga “dija se si bëhen gjërat” (ang. know-how) dhe kjo e fundit shpesh shndërrohet në një grumbull kompleks të kompetencave dhe sjelljeve. Studimet në lidhje me përkthimin janë një shembull i mirë i një fushe të re ndërdisiplinare që është ngritur brenda globalizimit, kjo në kohën kur përkthimi është një nga punët më të vjetra në histori.

Programi MA në Përkthim dhe Interpretim që duhet të fillojë në tetor 2011 në Prishtinë, qartësisht e përcjell Deklaratën e Bolonjës (1999) me konceptet bazë siç janë zbatueshmëria, fleksibiliteti, krahasueshmëria dhe është rezultat i analizës së nevojave.

Në mënyrë të vrazhdë, ai korrespondon me programet tjera në Përkthim dhe Interpretim në Evropë, në veçanti pasi që është përpiluar në bashkëpunim me tre partnerë evropianë (Strasburgu, Lublana dhe Milano), por sigurisht se një drejtim studimesh nuk paraqet vetëm një përmbledhje të thjeshtë në një listë të lëndëve mësimore dhe moduleve. Ai varet edhe nga mësimdhënësit, përgatitja e tyre, kompetencat, motivimi dhe udhëheqësi i ekipit që është i përkushtuar ndaj fillimit dhe zhvillimit të programit.

Në këtë fazë, mund të vërejmë se shumica e mësimdhënësve potencialë

- Përkthejnë dhe interpretojnë, veçanërisht në kontekst të literaturës; përvojat e tyre në përkthim nuk mund të jenë përveçse një përparësi, pavarësisht nga fakti se përkthimi literar nuk është puna më e paguar, megjithëse është me një prestigj dhe vjen në pah.
- Ata janë më të specializuar në studime letërsie, të lingistikës së kontrastit, se sa në studime të përkthimit;
- Ata kanë bërë shumë pak projekte hulumtuese, megjithëse disa nga ta kanë mbrojtur temat e tyre PhD ose janë regjistruar në studime të doktoratës.

Nga kjo perspektivë, ne mund të pyesim veten se si do të ndahen lëndët mësimore në mes tyre, kush do të mbikqyrë programin e përkthimit dhe interpretimit, qoftë ai interpretim në konferenca, gjykata ose në komunitet.

MA në përkthim dhe interpretim paraqet një ofertë të re dhe duke qenë e tillë, ai mund të ofrojë në të ardhmen e afërt një balans më të mirë në mes kërkesës dhe ofertës. Profesionistë të kualifikuar do të duhej të kishin ndikim në tregun e punës, veçanërisht nëse ata janë në gjendje të organizohen, të mbrojnë titullin e tyre dhe të planifikojnë arsimin e tyre të mëtejshëm.

Kishte një brengë të veçantë: nëse studimet kushtojnë 3300 Euro për dy vjet dhe diplomën, a do të ishte e gabuar sikur të pritët që përkthyesit dhe interpretuesit aktivë në këtë profesion do të tërheqen dhe do të jenë të gatshëm të regjistrohen, më shumë se sa studentët BA në gjuhë që nuk kanë përvojë ose shumë pak përvojë në përkthim? Në një rast të tillë, kjo do të kishte pasojë në lidhje me pritjet nga kandidatët dhe metodologjia që do të përdoret në ligjëratë.

Të gjithë studentët duhet të kenë një pasqyrë të qartë e të përgjithshme në lidhje me studimet e tyre dyvjeçare, në lidhje me synimet, rezultatet e mësimin të pritura, metodat e vlerësimit (provimet) dhe ngarkesën e pritur (30 kredi me 25 orë/1 kredi nënkupton 750 orë/semestër ose rreth 50 orë/javë për secilin student).

Përshkrimi dhe rezultatet e mësimit për të gjitha lëndët do të duhej të shpërndareshin te secili student dhe të prezantohen si dhe të diskutohen në fillim të secilës lëndë mësimore. Ato do të mund të vendoseshin në tabelën e lajmërimeve, në uebfaqe të programit të studimeve dhe në udhëzuesin e studimeve. Sasia e madhe e informatave të dhëna në mënyrë gojore parandalon paraqitjen e duhur dhe shpërndarjen e atyre informatave. Do të mund të postohet edhe udhëzuesi profesional/në lidhje me karrierë.

4. REKOMANDIMET

A) Para fillimit të programit në tetor 2011

Synimi im këtu është që të jap sugjerime në lidhje me atë se si të sqarohen dhe të cekën informatat që duhet t'iu japin studentëve dhe se si do të duhej krijuar një konsensus më preciz në mes studentëve/trajnesve.

1. Që të ketë **pajisje** të instaluar dhe të gatshme për përdorim:

Kabinat e interpretimit, harduerë/kompjuterë, softuerë (vegla përkthimi të mbështetura nga kompjuterët siç janë sistemet e përkthimit të bazuara në memorje, bazat e të dhënave të terminologjisë). Këto pajisje ngërthejnë në vete sesionet e planifikuara të trajnimit për mësimdhënës (si të përdoren pajisjet, si të integrohen në mësimdhënie).

2. Kompetencat dhe rezultatet e mësimit:

Këto janë shprehur në mënyrë eksplicite në dokumentin “Master Profesionale në Përkthim dhe Interpretim” (f. 123/f.1: cilësitë dhe shkathtësitë; dhe f.129-130/f.7-8). Vini re: f.129-130 nëse merrni në konsideratë dokumentin e quajtur *Pasqyrë e përgjithshme e Fakultetit Filologjik*, më datë 29.12.2010, dhe f.7-8 dhe dokumentin *Master Profesional* si një dokument i pavarur).

Kompetencat dhe rezultatet e mësimit do të duhej të riformuloheshin pjesërisht në mënyrë që:

- Të evitohen përsëritjet (p.sh.: “shkathtësitë e përkthimit”/“shkathtësitë për përpilimin e saktë të tekstit të përkthyer”)
- Që të renditen në mënyrë më logjike dhe koherente (p.sh. “njohuritë e thella në gjuhë” para “njohuritë e shkëlqyeshme në të gjitha aspektet stilistike”), ndoshta përmes diferencimit në mes kompetencave të përgjithshme dhe specifike (a është “shkathtësia e përkthimit” po aq e rëndësishme sa “shkathtësia e përdorimit të përkthimit të makinave”?)
- Të qartësohet kompetenca që duhet fitohet në fund të vitit të parë dhe/ose në fund të vitit të dytë.
- Të sigurohet që “njohuria tematike” (f.129/f.7) është përmendur (f.130/f.8) në një nga dy vjetët e programit.

(shih kompetencat e përmendura për Masterët Evropianë në Përkthim (ang.EMT):

http://ec.europa.eu/dgs/translation/programmes/emt/index_en.htm

3. Përshkrimi i lëndëve (f.130-133/f.8-11)

Disa përshkrime janë ende tepër shumë të orientuara drejt lingvistikës

- Psh. 4 Teoria e Përkthimit; 7 dhe 10, përkthimi $A \rightarrow B$ dhe $B \rightarrow A$; 13 Prezantimi para audiencës; 6 gjuha shqipe për nevoja të veçanta; tipet e dokumenteve që duhet të

- përdoren? Tipet e komunikimeve që duhet të studiohen: eksperti/ekspertët, etj. Tipi i specifikave që përdoret? Me ose pa hyrje në fushën nga një ekspert?)
- 5b: Lëndët zgjedhore (viti 1, semestri 1): “Komunikimet ndër-kulturore” duhet të përshkruhen.
 - Në përgjithësi, duhet të përshkruhen kompetencat e veçanta të synuara.
 - 3 dhe 8, përkthimi konsektiv: nuk ka referim ndaj marrjes së shënimeve? “Shkathtësia për të analizuar, sintetizuar dhe parashikuar”: një shkathësi specifike që do të mund të përmendej më herët f. 8). “Shkathtësia për të përdorur teknologjinë informative” (në 8 dhe 14): a do të mund të ishte kjo më specifike?
 - Interpretimi: tipet e ndryshme të interpretimit (Konferencat, gjykatat, dhe përkthimi në komunitet), që të gjitha këto duhet të përmenden.
 - 12 Metodologjia e Përkthimit dhe Interpretimit: a janë të ndërlidhura të dy synimet? (të përpilojë një fjalor analitik ...dhe të mësojë procedurat për punë kërkimore praktike). Si janë të ndërlidhura këto dhe në çfarë mase?

4. Specializimi(et)

(faqe 129/fund, f.7; f.132/në mes, f.10: “fushat e veçanta: juridike, e mjekësisë, tekstet ekonomike, etj.”)

- Duket se është vetëm si lëndë zgjedhore që ofrohet në vitin e 1/semestri 2.
- A ka burime njerëzore për të ofruar specializimet e ndryshme? (f.123/f.1 “ekonomi, drejtësi, teknologji, shkenca, etj.”)
- Specializimi nuk kufizohet në problemet sa i përket terminologjisë. Nevojitet “njohuria tematike” (f.123/f.1) para se të kuptohet dhe të përkthehet një “tekst i specializuar”. Si do të mundën studentët që të marrin njohuri themelore në një fushë të veçantë? A do të përfshihet kjo mënyrë e prezantimit në ligjëratat e përkthimit? Nga i njëjti mësimdhënës?
- Si do të ndërlidhen dhe zbatohen në “përkthimi në fushat e veçanta A, B, C” (9 lëndët zgjedhore, f.132/f.10) “aftësitë për të gjetur informacionin e nevojshëm”, “aftësitë për të përdorur kompjuterët dhe mjetet e tjera të teknologjisë”, “shkathtësitë për absorbimin e njohurive të reja”.
- Fjalorët dhe Terminologjia: A ka për synim një lëndë e tillë zgjedhore që të “pasurojë leksikon dhe terminologjinë e studentëve” në trajnim dhe terminologji (se si do të mund të përpilohej një fjalor? Si mund të kërkohen nocionet dhe konceptet? Si mund të organizohet terminologjia? etj.) Dy tipet e tezës së Masterit (f. 128/f.6 dhe f.129/f.7) a përfshijnë ato përgatitjen e një “fjalori të vogël”. A do të ishte e mundur kjo pas një trajnimi sistematik në terminologji?

→ Me fjalë të tjera, në planin e studimeve duhet të sqarohet vendi dhe shtrirja e specializimit. Do të ishte e pamundur që të ofrohej trajnim sipas nevojave dhe gjuhëve punuese të secilit student. Specializimi është një mundësi për të zbatuar një numër kompetencash specifike dhe të zhvillojë kompetencën në lidhje me atë se si të mësohet.

5. Gjuhët C

Shih 5 lëndët zgjedhore: Gjuhët Ballkanike, Gjuhët e Huaja C, Përkthimi nga C në A: f. 126/f.4, f.127/f.5, f.128/f.6.

- f.127/f.5: është thënë se “studentët mund të vendosin të mësojnë një gjuhë tjetër të huaj...”: a është fjala për mësim nga fillimi, apo për përmirësim të njohjes së asaj gjuhe C?
- f.129/f.7: “programi parashe mësimin e një gjuhe të huaj si gjuhë D..” A me të vërtetë mendohet D? Apo ndoshta do të ishte shkruar C?

→A është më mirë që të shumohen lëndët në gjuhë dhe përkthim (me drejtime të ndryshme: A-B, B-A, C-A) apo të rritet numri i orëve në specializim dhe përkthim të dokumenteve të specializuara?

6. Teza e Masterit (në përkthim dhe interpretim):

p.sh. përkthimet me shënime/komentim.

Cilado temë që zgjedhet nga studentët e avancuar, ata do të duhej të kishin **një lëndë në metodologjinë e punës kërkimore**.

Kursi 12 (metodologjia) duket se thekson vetëm aspektet formale të punës kërkimore (referencimi, shprehja e mendimit): Si do të mundet që studentët të njihen me “kompleksitetin e studimeve empirike në lidhje me premiset teroke të përkthimit dhe të studimeve të interpretimit”? Kur marrin ata “njohuri në punën kërkimore shkencore të nevojshme për tezën e Masterit”? (f.130/f.8) dhe mundësisht të vazhdohet me programin e doktoraturës (?-shih fundin e f.130/fundin f.8). Lënda mbi “Teorinë e Përkthimit” është planifikuar për Vitin 1/Semestri 1...shumë herët?

7. Do të duhej të jepeshin informata të qarta dhe precize në lidhje me atë se si orientohen studentët **për vitin e dytë** (drejtimi “Përkthim” ose “Interpretim”). Tani për tani, nuk organizohet ndonjë testim: a do të mund të jenë të vetmit parametra vlerësimet e profesorëve dhe notat ato që i ndihmojnë studentëve të “zgjedhin” drejtimin e tyre?

B) Të zhvillohet gjatë vitit të parë akademik 2011/2012

1. Me qëllimin që të përforcohet konsensusi në mes mësimeve sa i përket synimeve të kurikulës dhe metodologjisë së mjeteve pedagogjike, ne sugjerojmë që të organizohet **një mbledhje e rregullt çdo muaj** me të gjithë mësuesit dhe përfaqësuesit e studentëve. Shkëmbimi i përvojave, diskutimi i problemeve (si të përzgjedhen tekstet që duhet të përkthehen; si të vlerësohet puna në klasë; në grupe dhe individualisht; si të organizohen simulimet; detyrat ekipore; çfarë të pritet nga portofolio e përkthimit, etj) vetëm se do t’i sillnin dobi të gjithëve, do t’iu mundësonin një monitorim të vazhdueshëm dhe zhvillim.

2. **Vlerësimi** i punës nga studentët: sistemi (mënyrat dhe kriteret e vlerësimit) do të duhet të jenë më eksplicit, veçanërisht nëse ka vlerësime të vazhdueshme. Këto do të duhej të ishin të njëjta, pavarësisht nga gjuhët e punës.

3. **Puna praktike/stazhi** (“përvoja profesionale”): Synimet, mënyrat dhe procedurat duhet të sqarohen dhe të shkruhen. Duhet të sqarohet roli i të gjithë personave të përfshirë (universiteti, mësuesit, punëdhënësit, studentët). Do të mund të ngrihej një shërbim i veçantë ad-hoc, i cili do të mund të bazohej në përvojat e fituara, p.sh. në programin e Gazetarisë.

4. **Përcjellja e të diplomuarve**: Duhet të zhvillohen analiza të rregullta në lidhje me nevojat e tregut të punës, evoluimin e praktikave profesionale dhe ndimi i teknologjisë në punë, kjo me qëllimin që të mbahet ritmi me këto zhvillime. Këto analiza duhet të bëhen të paktën një herë në gjashtë vjet (përmes anketave, intervistave, grupeve të fokusit, etj). Rezultatet mund të merren

parasysh në lidhje me ndryshimin e kurrikulës dhe të kompetencave që ofrohen, si dhe në programin e vazhdueshëm të edukimit për përkthyes dhe interpretues aktivë.

5. Qëndrimi jashtë vendit: Studimet jashtë vendit është vështirë të realizohen si rrjedhojë e dy pengesave kryesore: kërkesa për viza dhe financimi – edhe pse është në dispozicion edhe programi Erasmus. Sidoqoftë, në këtë rast kemi të bëjmë me një synim afatgjatë, që ka të bëjë me ngritjen e marrëdhënieve ndërkombëtare, duke përfshirë mobilitetin e mësimdhënësve.

6. Vizibiliteti: Programi Master Profesional do të duhej të kishte një politikë të qartë të komunikimit kundrejt:

- palëve me interes (organizatave private të punësimit, institucioneve ndërkombëtare/evropiane, shoqatave profesionale dhe huanitare, kompanive të përkthimit, etj).

- dhe Universitetit (që njihet, të pranohet si një program inovativ ndërdisiplinar).

Programi Master duhet të informojë në baza të rregullta administratën, personelin e disiplinave tjera, organet vendim-marrëse dhe shërbimet e përfshira në sigurimin e cilësisë. Ka forma dhe formatë të ndryshme për këtë: takime, seminare, buletine, uebfaqe, ngjarje të veçanta, fushata të vetëdijësimit, kontakti me media, etj.

Vizibiliteti i Programit është i rëndësishëm dhe atë që nga fillimi i tij, edhe që nga pranimi i kandidatëve (në fakt kjo bëhet e rëndësishme edhe për faktin se ka taksa të larta të regjistrimit (3300 Euro për dy vjet).

7. Pas tri vjetësh do të duhej bërë një **vlerësim i kurrikulës** (në pranverë 2014), në fakt pas dy viteve të para të programit dhe pas një viti punë për gjeneratën e parë të të diplomuarve (shih pikën 4 më sipër). Vlerësimi, me përgjigje nga të diplomuarit dhe mësimdhënësit do të duhej të ishte në lidhje me rëndësinë e lëndëve, efikasitetin e trajnimit, dobësitë dhe pikat e forta të kurrikulës, shkallën e kënaqësisë me punën, etj. Atëherë do të mund të themelohej një **shoqatë e të diplomuarve**, kjo si një hap drejt themellimit të një shoqate kosovare të përkthyesve dhe interpretuesve.

PS Lista e referencave (f.133-136/f.11-14). Komentet në këtë listë të literaturës themelore:

Disa nga referencat nuk është lehtë të qasesh në to, ato janë tepër të specializuara, është vështirë t'i lexosh dhe/ose nuk mund të paraqesin prioritete tani për tani. Për këtë arsye unë propozoj që të përjashtohen referencat 5, 7, 8, 9, 13, 18, 19, 20, 21, 23, 26, 37, 38, 45, 49, 50, 51, 56, 60, 61, 63, 64, 70, 71, 75, 81, 82, 85.

6 është njëjtë sikur 2 dhe 89 si 35.

Unë ia bashkangjes një listë tjetër (disa nga çështjet janë të përmendura në të dyja listat)